

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 22-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 20.05.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:** dr. Metodija Jançeski.

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 22-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri me 5 vota „pro“, miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 21-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 10.05.2024.
2. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë.
4. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 21-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 10.05.2024, me tekstin e propozuar.

**Pika 2**

Z. Trajçevski shpjegoi se do të bëj një hyrje për të dy transmetuesit që janë në rendin e ditës si pikë 2 dhe 3, sepse shkak për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes është i njëjtë. TV SHENJA nga Shkupi dhe JON –RADIO nga Struga u janë dhënë fatura për pagesë të kompensimit vjetor për lejen e transmetimit në radio dhe televizion, por deri në afatin e fundit që ishte deri të premtën e kaluar, nuk është kryer pagesa. Është realizuar komunikim me të dy transmetuesit, në të cilën kanë treguar se shkaqet janë të natyrës financiare dhe pritet të marrin mjete nga KSHZ për transmetimin e reklamave politike me pagesë nga rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale, nga ku afati i fundit është 27 maj, ndërsa afati i fundit plotësues për pagesën e mjeteve ndaj Agjencisë është 31 maj. Shpresojnë se KSHZ në kohë do t'u paguajë mjetet transmetuesve, që të mund të kryejn pagesën për kompensimin vjetor Agjencisë.

Këshilli i Agjencië njëzëri ka inicuar procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023, për mospërbushje të detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk kanë paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0138 datë 11.04.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

### **Pika 3**

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk kanë paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0137 datë 03.04.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

### **Pika 4**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim, nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**